



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.546/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Violeta Husaj Rugova kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e Subjektit Politik Lëvizja VETVENDOSJE!, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Koalicioni për Familjen, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat A.nr.546/2025, Anr.547/2025, Anr.560/2025, Anr.567/2025, të datës 10.02.2025, të parashtruar nga subjekti politik Lëvizja VETËVENDOSJE! me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Koalicioni për Familjen, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar ankesat: Anr.546/2025, Anr.547/2025, Anr.560/2025, Anr.567/2025, më datë 10.02.2025.

Në ankesat A.nr 546/2025, Anr.547/2025, dhe Anr.567/2025, pretendojnë se aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, kanë identifikuar se: Koalicioni Lista për Familjen në postimi e tij të sponsorizuar në portalin e faqes së gazetës FolPlus më 9 shkurt 2025 në ora 7:00 e tutje, kandidati Selim Pacolli, me postimin e tij të sponsorizuar, në llogarinë e tij në rrjetin social Facebook, më 9 shkurt 2025 në ora 7:00 e tutje, po ashtu edhe kandidati dhe prijësi i listës Eman Rrahmani nga radhët e koalicionit Lista për Familje me postimin tij të sponsorizuar në llogarinë e tij në rrjetin social Facebook, më 9 shkurt 2025 në ora 7:00 e tutje, kanë thyer heshtjen zgjedhore.

Në ankesën Anr.560/2025, pretendojnë gjithashtu se Albin Rrahmani simpatizues i subjektit "Lista për Familje" dhe vëllai i bartësit të listës ka postuar disa herë në rrjetin social Facebook lidhur me zgjedhjet, ka postuar në orën 11:42 me tekst "12 NANE [/] Për FAMILJEN ...!" Qartazi ka përdorur dhe sloganin e subjektit në këtë postim, në orën 12:41 ka postuar tekstin : "129 persona i kamë përpara në radhë. U kënaqëm duke votuar për familje!" 129 është numri i listës i subjektit në fjalë, ndërsa në orën 13:31, ka postuar një fotografi në rrjetin Facebook me këtë përshkrim: Më kishin vendosur një mesazh para vendvotimit, ej, v Allah, e kam shtypur kimikun fort "PER FAMILJE" ku Z.Rahmani qartazi ka përdorur emrin dhe sloganin e subjektit në fjalë.

Nga të lartcekurat pretendohet se ditën e zgjedhjeve me dt. 09 shkurt 2025 kanë bërë fushatë zgjedhore edhe pse heshtja zgjedhore ka filluar me hapjen e qendrave të votimit për votim përkatësisht në orën 07:00. Më tutje në ankesa pretendohet se kandidatët në fjalë dhe Koalicioni për Familje me veprimet e tilla kanë bërë shkelje të nenit 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, si dhe nenit 8, paragrafi 1.5 të Rregullores Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Parashtruesi i ankesave, kanë theksuar në ankesa me nr. për ankesat Anr.546/2025, Anr.547/2025, dhe Anr.567/2025, si provë ka bashkangjitur CD që dëshmojnë shkeljet e tilla të bërë në ditën e zgjedhjeve. Ndërsa për ankesën Anr.560/2025, parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të postimeve si dhe linqet e postimeve në rrjetin social Facebook si: <https://shorturl.at/KKIoS>, <https://shorturl.at/u8mEr>, <https://shorturl.at/KwObg>. Andaj kërkojnë nga PZAP që të shqiptoj masë sanksionuese kandidatëve dhe Koalicionit Lista për Familje.

Më datë 10.02.2025, PZAP-i, e njoftoi Koalicionin Lista për Familje, me seli në Prishtinë për ankesat e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje, mirëpo Koalicionin Lista për Familje, nuk është përgjigjur as në afatin e paraparë deri më datë; 11.02.2025.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.546/2025, Anr.547/2025, Anr.560/2025, Anr.567/2025 të datës 10.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.546/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekte politike LVV, kundër Koalicioni Lista për Familje për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

-Ankesat janë të pabazuara

Paneli pas vlerësimit të ankesave dhe provave të bashkangjitura në ankesat e cituara më lartë, konstatoi se parashtruesi i ankesave nuk ka paraqitur CD siç pretendohet në ankesat

Anr.546/2025, Anr.547/2025, dhe Anr.567/2025. Megjithatë paneli pasi që i shqyrtoj ankesat dhe provat e bashkangjitura si dhe pa hetimeve të bëra, erdhi në përfundim se pretendimet e ankuesit, se mbështetësit dhe kandidatët e subjektit politik Koalicioni për Familje kanë thyer rregullat zgjedhore ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara.

Paneli bazuar në provat e bashkangjitura dhe hetimet e bëra vlerëson se nuk ka dëshmi të qarta dhe konkrete të cilat provojnë faktet e paraqitura në ankesë, përkatësisht se Koalicioni për Familjen te këtë bërë veprime të ndaluara gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës,

Paneli duke analizuar ankesën Anr.546/2025 vërtetoi se shkelja e pretenduar sipas kësaj ankese nuk mund të konsiderohet shkelje e rregullave në ditën e zgjedhjeve pasi që nga shikimi i postimit në rrjetin social Facebook të kandidatit Selim Pacolli, rezulton se i njëjti postim nuk figuron në profilin e rrjetit social facebook të kandidatit në fjalë, ndërsa nga dëshmia e paraqitur nuk mund të vërtetohet se postimi ishte bërë ditën e zgjedhjeve me dt.09.02.2025.

Paneli duke analizuar ankesën Anr.547/2025 vërtetoi se, shkelja e pretenduar sipas kësaj ankese nuk mund të konsiderohet shkelje e rregullave në ditën e zgjedhjeve pasi që nga shikimi i postimit në rrjetin social Facebook të Koalicionit për Familje rezulton se i njëjti postim nuk figuron në profilin e rrjetit social facebook të kandidatit në fjalë, ndërsa nga dëshmia e paraqitur nuk mund të vërtetohet se postimi ishte bërë ditën e zgjedhjeve me dt.09.02.2025, siç pretendohet në ankesë.

Paneli duke analizuar ankesën Anr.560/2025 vërtetoi se, postimet e pretenduar në ankesë nga Albin Rrahmani është vërtetuar se ende është aktive por nuk ka slogan dhe numër të subjektit ndërsa dy postimet e tjera të pretenduara në ankesë nuk janë aktive, ndërsa nga dëshmia e paraqitur nuk mund të vërtetohet se postimi ishte bërë ditën e zgjedhjeve me dt.09.02.2025, siç pretendohet në ankesë.


Paneli duke analizuar ankesën Anr.567/2025 vërtetoi se nga kandidati Eman Rrahmani për deputet nga Koalicioni Familja postimin e tij të sponsorizuar në llogarinë e tij në facebook ende është aktive, dhe është postuar disa ditë para datës së zgjedhjeve dhe nuk është bërë shkelje e rregullave zgjedhore ditën e votimit siç pretendohet në ankesë.

Kështu që PZAP-i pretendimet ankimore të cituara si më lartë i vlerëson si të pabazuara dhe të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi të qarta, pasi që nga provat e bashkangjitur ankesave nuk vërtetohet se nga Koalicioni për Familje është shkelur neni 37 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i LZP, si dhe neni 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores 07/2024. Andaj duke u mbështetur në nenin 1 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli ankesat e lartcekura si të tilla i refuzoj si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga sa u tha më lartë ankesat vlerësohen si të pabazuara duke u bazuar në nenin 118, paragrafi 1, të LZP-së, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.546/2021 më datën 13.02.2025.

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshillë Juridike; Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.